



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura V  
Sesioni pranveror

---

Komisioni për Punë të Jashtme  
Mbledhja nr. 48  
Prishtinë, më 3 shkurt 2017, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Elmi Reçica, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, dhe Ismet Beqiri.

**Munguan:** Teuta Rugova, Puhie Demaku, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

**Pjesëmarrës nga Ministria e Integrimit Evropian:** Anila Statovci-Demaj, zëvendësministre, Valon Gashi, drejtor, Vjosa Beqaj, drejtor, Dukagjin Abdyl, drejtor, Artan Çollaku, drejtor, Florim Canolli, drejtor dhe Jeton Karaqica, drejtor.

**Nga zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Donika Kadaj, deputete, Gurjeta Zeka, LVV, Eugen Cakolli, KDI dhe Blerta Bejtullahu, EUSR/EU Office.

**Mbledhjen e kryesoi:** Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 18 dhe 25 janar 2017;
3. Raportimi i zëvendësministres së Ministrisë së Integrimit Evropian, znj. Anila Statovci-Demaj;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari propozoi që raportimi izëvendësministres së Ministrisë së Integrimit Evropian, znj. Anila Statovci-Demaj, të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

*Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi propozimin që pika e parë e rendit të ditës të jetë raportimi i zëvendësministres.*

### **3. Raportimi i zëvendësministres së Ministrisë së Integritit Evropian, znj. Anila Statovci-Demaj**

**Elmi Reçica**, njoftoi se Samiti i kryetarëve të komisioneve për punë të jashtme do t'i trajtojë temat me të cilat Ballkani dhe Bota sot po përballen siç janë terrorizmi, imigrimi, barrierat politike, integrimi në organizata ndërkombëtare, anëtarësimi në BE dhe çështjet tjera. Kërkoj që zëvendësministrja të njoftojë lidhur me çështjet e rëndësishme me të cilat Kosova po përballlet sa i përket integritit në organizata ndërkombëtare, cilat janë barrierat, si dhe lidhur me procesin e MSA-së. Z. Reçica njoftoi se bazuar në marrëveshjen e datës 19 prill 2013, pika 14 e cila thotë se “asnjëra palë nuk do të bllokojë dhe nuk do të inkurajojë palët tjera të bllokojnë procesin e integritit në organizata ndërkombëtare.” Lidhur me këtë tha se ne jemi të vetëdijshëm që në vazhdimësi Serbia e bllokoi këtë proces dhe kjo nuk është në favor të Kosovës. Ai, tha se qëllimi i këtij takimi është që deputetët të jenë sa më të informuar sepse gjatë samitit do të dalin tema nga më të ndryshme.

**Anila Statovci-Demaj**, tha se Komisioni për Punë të Jashtme ka rol të rëndësishëm në kuadër të ofrimit të lobimit për vendet e BE-së. Ajo theksoi se prioriteti më i rëndësishëm për qytetarin e Kosovës është liberalizimi i vizave dhe se kanë mbetur të plotësohen dy kritere, demarkacioni si dhe të tregohen rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Znj. Statovci-Demaj, njoftoi se në kuadër të prokurorisë speciale është krijuar një e ekip, i cili ka shënjuar 34 raste të profilit të lartë të korrupsionit, janë ngritur 25 aktakuza, tri raste janë në hetime të shkallës së parë, tri raste janë në hetime të shkallës së dytë dhe 11 raste janë në shqyrtim kryesor. Sa i përket MSA-së, ajo njoftoi se në nëntor të vitit të kaluar është mbajtur takimi i parë i Këshillit të MSA-së dhe se Ministria e Integritit Evropian ka përgatitur kalendarin e takimeve për të gjitha nën-komitetet e MSA-së. Më qëllim të intensifikimit të zbatimit të MSA-së, në muajin nëntor, Kryeministri Mustafa dhe Komisioneri Hahn, lansuan Agjendën Evropiane të Reformave – ERA, agjendë e nivelit të lartë politik dhe qëllimi i saj është që të ngritet vetëdija lidhur me zbatimin e MSA-së. Sa i përket zbatimit të ERA-së, deri më tani ka zbatim të kënaqshëm dhe se Qeveria e ka miratuar dhe së shpejti do të miratohet në Kuvend Projektligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Ajo, po ashtu njoftoi se është duke u punuar që deri në fund të këtij viti të miratohet legjislacioni i nevojshëm për suspendimin dhe largimin e zyrtarëve publikë, të akuzuar apo dënuar për korrupsion dhe se në pjesën e parë të këtij viti do të bëhet edhe auditimi i raporteve financiare të partive politike. Lidhur me fuqizimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ajo njoftoi se do të rekrutohen 67 gjyqtarë të rinj në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës dhe ftoi anëtarët e Komisionit që të koordinohen veprimet për të siguruar që partitë politike të publikojnë raportet financiare. Kriter tjetër që mbetet të plotësohet nga Kuvendi, tha se është përfshirja në strategjinë legjislative zbatimi i Ligjit për financimin e partive politike. Element tjetër të rëndësishëm përmendi programet e BE-së. Këto programe, tha se janë një prej kontratave të rëndësishme dhe që konsiderohet një aktivitet domethënës, përmes të cilit shprehet përkrahja e BE-së ndaj Republikës së Kosovës. Ajo njoftoi se MIE ka koordinuar hapat e nevojshëm me qëllim të analizimit të programeve. MIE bën koordinimin e donatorëve dhe të asistencës financiare të BE-së nëpërmjet fondeve të IPA-së dhe se kanë finalizuar programimin e pakos vjetore IPA 2016. Ajo tha se kanë përfituar financim në vlerë prej 45.5 milionë euro në fushat e sundimit të ligjit, arsimit dhe të punësimit. Ajo, po ashtu njoftoi se Kosova për herë të parë do të jetë pjesë e mbështetjes buxhetore në sektorin e reformës së administratës publike me një shumë totale prej 25 milionë euro. Lidhur me acquiscommunaire, tha se kanë përkthyer 126 akte normative të BE-së në gjuhën shqipe, në koordinim me MIE-n të Shqipërisë, kanë përgatitur manualin e përbashkët për përkthimin e legjislacionit në gjuhën shqipe dhe se gjatë vitit

2016, kanë kontrolluar përputhshmërinë e 138 projekt-akteve normative. Ajo njoftoi se në kuadër të ERA-së, në Kosovë ka qëndruar Nënkomiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri, me të cilin janë përpunuar elementet që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit dhe se BE-ja ka cilësuar se ka pas një përparim të konsiderueshëm në atë drejtim.

**Elmi Reçica**, njoftoi se Samiti i kryetarëve të komisioneve të punëve të jashtme mbahet nga data 19 – 22 shkurt 2016, me temën “E ardhmja e Ballkanit në Evropë dhe integrimet euro-atlantike”. Në kuadër të kësaj, tha se do të trajtohen katër tema, të cilat do të debatohen gjatë paneleve. Në panelin e parë, tema do të jetë “Perspektiva e zgjerimit të BE-së, hapja e dyerve për vendet e Ballkanit”, paneli i dytë do të diskutojë për temën “Thellimi i bashkëpunimit në mes të vendeve të Ballkanit drejtë integrimin në organizata ndërkombëtare, tejkalimi i barrierave politike”, paneli i tretë për temë do ta ketë “Krizë e emigrimit të refugjatëve” dhe paneli i katërt, me temën “Politikat evropiane të luftës kundër terrorizmit dhe radikalizmit në Evropë”. Z. Reçica njoftoi se deri më tani pjesëmarrjen e kanë konfirmuar rreth 40 personalitete nga vende të ndryshme dhe se ftesë i është dërguar edhe Serbisë si dhe 5 vendeve të BE-së që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Ai po ashtu njoftoi se Samiti është organizim i Kuvendit të Kosovës, dhënk do të mbahet në Kuvend, por në një hotel, për t’iu mundësuar edhe atyre vendeve që hezitojnë të vinë në institucione, të jenë pjesëmarrës. Sa i përket programit IPA-s, z. Reçica tha se mundësitë janë të mëdha, se edhe deputetët duhet të ofrojnë mbështetjen e tyre

**Blerta Deliu-Kodra**, lidhur me çështjen e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, tha se institucionet po punojnë në këtë drejtim, ndërsa sa i përket procedimit të demarkacionit pyeti se a duhet të ketë qasje më proaktive të aktorëve politikë në lehtësimin e zgjidhjes së çështjes së demarkacionit. Ajo tha se qytetarët e Kosovës vazhdimisht përballesh me telashe në marrjen e vizave edhe rastet shëndetësore dhe studentore, për të cilat kategori shprehu mendimin se duhet të ketë lehtësime. Znj. Deliu-Kodra pyeti se sa po përfshihet Kosova në programet e shumta të BE-së, dhe njoftoi se Komisioni ka miratuar marrëveshjen ndërkombëtare për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, ku Kosova përfaqësohet me fusnotë, mirëpo, Komisioni këtë hap e ka marr në mënyrë që të mos izolohet Kosova si shtet. Lidhur me përfshirjen e Kosovës në asistencën për reformë në administratën publike, pyeti e se si e parashihet reformimin e administratës publike dhe cila do të jetë qasja e institucioneve ndaj kësaj reforme. Për programin ERASMUS dhe programet tjera të edukimit, pyeti se çfarë po bën Qeveria në këtë drejtim që të kryej obligimet e saja karshi këtyre fondeve. Sa i përket nënshkrimit të MSA-së dhe rekomandimit pozitiv për liberalizimin e vizave, ajo pyeti se, a po zbatohen këto procese dhe sa po përfiton qytetari i Kosovës nga këto marrëveshje. Deliu-Kodra shprehu mendimin se Kuvendi duhet të përfshihet më tepër në procesin e liberalizimit të vizave dhe çështjes së përafrimit me BE-në, të ketë qasje më aktive dhe të jetë më i informuar se çka po ndodh, ndërsa pyeti se sa po rrezikon Kosova që të mos përfshihet në projektet e mëdha të BE-së.

**Luljeta Veselaj-Gutaj**, Lidhur me kriteret e mbetura për liberalizimin e vizave, tha se janë kriteret të cilat me kohë mund të përmbushen. Sa i përket kriterit për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ajo tha se kjo nuk do të thotë që të ndalohet njëherë dhe nuk duhet të punohet më në atë drejtim, Kosova duhet vazhdimisht të punojë në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, kurse pyeti se ku konkretisht ka mbet Kosova në procesin e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, sa ka përparuar Kosova pas nënshkrimit të MSA-së, pasi që ekziston edhe plani kombëtar për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Lidhur me programet e IPA-së, tha se për të përfituar nga këto programe kërkohen

projekte të detajuara dhe pyeti se a ka profesionistë të cilët përgatisin projekte të tilla për të përfituar nga këto programe.

**Qerim Bajrami**, tha se duke dëgjuar raportimin e znj. Statovci, mund të nxjerrim përfundim se MIE është duke punuar në nivelin e duhur. Ky pyeti lidhur me çështjen e anëtarësimit të Kosovës në BE ngase shpesh ka vërejtje për mosëmrimin e ministrit të MIE-së, dhe në këtë kontekst pyeti se sa koordinohen me zyrën në veriun e Mitrovicës, ngase raportet ditore nga atje janë të rëndësishme për BE-në, e të cilat zhvillime atje janë të ndikuara nga pushteti serb. Ai po ashtu pyeti se a ka në mesin e të punësuarve në MIE ndonjë shërbyes civil nga komuniteti boshnjak.

**Ismet Beqiri**, lidhur me liberalizimin e vizave tha se janë plotësuar 99 kritere dhe kjo nuk është për tu nënçmuar, është punë që duhet vlerësuar, por nuk mund të jemi të kënaqur sepse ajo që e kemi synim ende nuk është arritur. Sa i përket kushtit për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, Beqiri tha se është një punë dhe proces permanent dhe nuk e ka fundin, kurse sa i përket kushtit për demarkacionin tha se ratifikimi i marrëveshjes është kusht i padrejtë dhe se ky kusht nuk i është vënë shteteve tjera. Beqiri theksoi se roli i Kuvendit dhe i deputetëve duhet të jetë më i madh dhe të jenë pjesë e delegacioneve të ndryshme sa i përket diplomacisë parlamentare. Është e rëndë t'i shohësh pas një kohe të gjatë njerëzit duke prit për nevoja elementare, prandaj duhet të punojmë që sa më shpejtë që është e mundur të lëvizim lirshëm.

**Donika Kadaj-Bujupi**, pyeti zëvendësministren se a e konsideron të rëndësishëm postin dhe rolin e ministrit në raport me punën që bëhet në drejtim të integriteteve evropiane, dhe pse është ende vakant posti i ministrit. Sa i përket luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, ajo tha se sipas indeksit të korrupsionit të TransparencyInternational të vitit 2016, Kosova e zë vendin e 95, sindër vendet më të korruptuara. Ajo tha se Ministria e Drejtësisë në strategjinë legjislative për vitin 2016, nuk e ka përmbushur zotimin se do ta procedojë Projektligjin për konfiskimin e pasurisë së paligjshme, dhe se nuk është paraparë procedimi i këtij projektligji në strategjinë legjislative për vitin 2017. Lidhur me luftimin e korrupsionit, tha se duhet ta luftojmë korrupsionin në rend të parë për shkak të zhvillimit të shtetit e pastaj për shkak të liberalizimit të vizave dhe integriteteve.

**Anila Statovci-Demaj**, sa i përket demarkacionit tha se është jashtë mandatit të MIE-së, kurse sa i përket luftës kundër korrupsionit, tha se është proces afatgjatë dhe është term shumë i gjerë, por për efektet e plotësimit të kritereve për liberalizimin e vizave është marr një aktivitet konkret. Zëvendësministrja shtoi se ajo që po kërkohet të dëshmohet është se, ka një sistem të vazhdueshëm, një procedurë e rregullt e gjyqësorit dhe prokurorit për mënyrën se si identifikohen rastet e korrupsionit të lartë, si trajtohen ato dhe në çfarë mënyre mbyllen. Lidhur me demarkacionin, znj. Statovci-Demaj, tha se është shndërruar në një kriter problematik, për të cilin edhe BE-ja dëshiron të shoh se ne jemi të aftë të punojmë në mënyrë të unifikuar. Ajo njoftoi se pozicionimi për liberalizimin e vizave ka kaluar edhe në kuadër të shteteve anëtare, nuk është më vetëm BE-ja që vepron dhe se brengë është çështja e migrimit. Koordinimi me BE-në tha se është shumë i mire, kanë koordinim të vazhdueshëm me nivelin teknik dhe po mendohet që të sistematizohet më shumë koordinimi në mes të BE-së, MIE-së dhe Qeverisë së Kosovës. Lidhur me zbatimin e MSA-së, ajo theksoi se ERA është prioritet i MSA-së dhe se janë të fokusuar në zbatimin e prioritetëve të ERA-së. Lidhur me programet IPA dhe programet tjera të asistencës financiare, tha se është biseduar me zyrtarët në Bruksel dhe nëse objektivi i Republikës së

Kosovës është anëtarësimi në BE, atëherë nga ajo dalin detyra të caktuara me qëllim që të sigurohet realizimi i objektivit të anëtarësimin në BE. Znj. Statovci-Demaj, përmendi rastin e Shqipërisë në lidhje me programin ERASMUS, e cila ka konkurruar me 54 projekte të pasuksesshme dhe shtoi se duhet të jemi të sigurt që të konkurrojmë në ato programe ku kemi dëshmi se ka kapacitet brenda Kosovës për të konkurruar. Pyetjes së deputetit Bajrami, iu përgjigj se nuk e din nëse ka ndonjë të punësuar në MIE nga komuniteti boshnjak. Sa i përket Fonditë Ballkanit Perëndimor, tha se anëtarësimi në organizata ndërkombëtare nuk është në mandatin e MIE-së, por është në mandatin e MPJ-së.

**Florim Canolli**, njoftoi se Kosova prej fondit IPA përfiton në nivel kombëtar, dhe se nga programi IPA për bashkëpunimin ndërkufitar me vendet e rajonit, Kosova përfiton prej bashkëpunimit ndërkufitar me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Po ashtu, tha se Kosova përfiton prej IPA-s me shumë përfituese që jepet në nivel të Ballkanit Perëndimor, përfiton prej instrumentit të kornizës investuese të Ballkanit Perëndimor, që është një kombinim i fondeve të BE-së me donatorë të tjerë dhe me institucionet financiare ndërkombëtare, ku jepen grande për studime të ndryshme, grande investuese infrastrukturore si dhe kredi të ndryshme. Si projekte të suksesshme përmendi projektet në Komunën e Prishtinës, siç janë Termokosi dhe Ujësjellësi, që kanë përfituar shuma të mëdha prej fondeve të IPA-s dhe kornizës investuese të Ballkanit Perëndimor dhe donatorëve të tjerë. Ai njoftoi se në periudhën e IPA 1, Kosova ka pas shumë pengesa, ndërsa në periudhën IPA 2, janë zbutë kriteret dhe i është mundësuar Kosovës të ketë më shumë mundësi qasjeje në fondet e BE-së. Lidhur me programet e BE-së tha se ende nuk janë përfunduar të gjitha punët rreth qasjes së Kosovës në këto programe, duke shtuar se nga ana e Kosovës janë plotësuar të gjitha procedurat dhe se ka mbet që Këshilli dhe Parlamenti të vendosin. Sa i përket IPA 2016, njoftoi se ajo përbëhet nga dy pjesë, njëra pjesë do të financohet përmes projekteve, ku BE-ja ndanë 45.5 milionë euro në disa sektorë, të cilat menaxhohen nga Zyra e BE-së në Kosovë. Ndërsa, pjesa tjetër në vlerë prej 25 milionë euro, prej tyre 22 milionë euro jepen si përkrahje e drejtpërdrejtë në buxhetin e Kosovës dhe 3 milion euro jepen si asistencë teknike që përkrah implementim e projektit. Z. Canolli njoftoi se programi ERASMUS+ do të jetë pjesë e programeve ku do të kemi qasje, për shkak se e kemi një përvojë, dhe shtoi se Kosova do ta ketë përkrahjen e BE-së në asistencë teknike për të pasur qasje në programe të ndryshme. Ai shtoi se Kosova ka nevojë për profesionistë që dinë të shkruajnë dhe të përgatisin projekte dhe se kjo lidhet edhe me reformën e administratës publike.

**Anila Statovci-Demaj**, tha se shumë aktivitete të BE-së, varen prej kapacitetit tonë për t'i shfrytëzuar, si për IPA ashtu edhe për programet e BE-së, MSA-në, anëtarësimi, liberalizimii vizave etj., janë kritere që na imponohen. Me tej shtoi se nëse dëshirojmë të arrijmë anëtarësim në BE atëherëduhet të punojmë që të përfaqësohemi me standardet e BE-së.

**Elmi Reçica**, tha se Procesi i Berlinit kërkon që Ballkani Perëndimor të jetë i përafuar me zhvillimet e gjithanshme me BE-në dhe vetëm si i tillë mund të integrohet. Z. Reçica shtoi se në kuadër të kësaj janë zhvilluar shumë procese, Kosova është pjesë e atyre proceseve dhe se është duke lëvizur suksesshëm duke e pas parasysh të kaluarën. Kosova është shtet i ri dhe ka ndërtuar struktura dhe infrastrukturë tërësisht të re dhe është duke lëviz shpejtë drejtë integritit në BE..

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 18 dhe 25 janar 2017;**

*Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 18 dhe 25 janar 2017.*

## **4. Të ndryshme.**

**Elmi Reçica**, njoftoi se është planifikuar që të realizohet një vizitë zyrtare e Komisionit në Republikën e Shqipërisë me datë 9 dhe 10 shkurt 2017.

*Pas diskutimeve Kryetari konstatoi se Komisioni vendosi të realizojnë vizitë zyrtare në Republikën e Shqipërisë nga data 9 deri më 10 shkurt 2017.*

**Elmi Reçica**, njoftoi se do t'i dërgohet ftesë Ambasadorit Zahir Tanin, Përfaqësues Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për mbajtjen e një takimi, për t'i diskutuar raportet në mes të Kosovës dhe OKB-së.

**Qerim Bajrami**, hapi diskutimin lidhur me realizimin e vizitës zyrtare në Bosnje e Hercegovinë. Ai po ashtu diskutoi lidhur me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Parlamentit të Bosnje e Hercegovinës në Samitin e kryetarëve të komisioneve të punëve të jashtme.

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me kohën e mundshme për realizimin e vizitës zyrtare në Bosnje e Hercegovinë dhe nxorën këtë

### *Përfundim*

*Të realizohet vizita zyrtare e delegacionit të Komisionit për Punë të Jashtme në Bosnje e Hercegovinë nga data 5 deri më 8 mars 2017.*

**Blerta Deliu Kodra**, njoftoi se në raportin e Fondit për të Drejtën Humanitare është thënë që 110 zyrtarë serbë i kanë fsheh dëshmitë e tyre në lidhje me krimet e luftës në Kosovë. Lidhur me këtë propozoi që znj. Natasha Kandiç, themeluese e këtij Fondi, të ftohet në Komision për ta paraqitur raportin e saj, lidhur me fshehjen e dëshmive nga zyrtarët serbë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

---

Elmi Reçica